



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:015456  
Datë: 25.05.2018  
Numri i dokumentit: 00044926

**P.nr.505/16**

**NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA NË SUHAREKË**, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lëndën penale sipas P.Th.nga Prizreni, aktakuzës PP.nr.3742/15 të dt. 29.06.2016, ndaj të akuzuarit A.B nga fsh S. Komuna Suhareke, i akuzuari për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-se, në prezencë të prokurorit të PTH-së, nga Prizreni Besim Susuri dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt.18.05.2018, mori publikisht shpallin dhe me datë 24.05.18 përpilo këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari A.B nga i ati E. e ema Gj. e lindur R, i lindur me dt. 25.05.1969 në S, ku dhe tani jeton, me numër personal ..... i martuar, baba i dy femijeve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i denuar me parë, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datë 09.03.2015 në orë të pavërtetuar, në fshatin S.Komuna Suhareke, merr perdorë duke u furnizuar përmes rrjetit përques të rrymes apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike, në mënyrë direkte duke anashkaluar njesorin elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me qrast të demtuarës K. – Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëm material në vlerë të energjisë së shpenzuar.

Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-se.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 51, 52, 73, 74 KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 320 KPK-së, të akuzuarit, i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Duke i vërtetur dënimin me burgim prej 3 (tre) muajve, si dhe dënimin me gjobe ne shume prej 100 (njeqinde) euro, te cilat dënime nuk do te ekzekutohen në afatin e verifikimit prej një viti nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari ne emer te paushallit gjyqesor te paguaj shumen prej 20 euro, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 30 euro, te gjitha pas plotefuqishmerise se ketij atgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar, K. –Distrikti ne Prizren qe kërkesën pasurore-juridike ta realizoje ne kontest te rregullt civil.

### A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze, PP.nr. 3742/15 te dt. 29.06.2016, ndaj te akuzuarit A.B nga fsh.S.Komuna Suhareke, për shkak te veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se , te cilin gjatë seancës se shqyrtimit fillestare e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Besim Susuri, i cili ne tërësi ngel pranë te dhënave si ne aktakuze, qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH-së ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga aresyet dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmbanë aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te Kodit penal, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoj dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bere pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetare, është penduar për veprën e kryer, është hera e pare qe bie ndesh me Ligjin.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së . Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 par, 1 te KPP-së.

### **GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE**

**Gj y q t a r i**  
Qemail Suka

**KESHILLE JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.